



**FKEE**

FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË  
KOSOVSKI FOND ZA ENERGETSKU EFIKASNOST  
KOSOVO ENERGY EFFICIENCY FUND

Republika e Kosovës  
Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE)

---

**Rregullore BDFKEE - Nr. 01/2023  
për plotësimin dhe ndryshimin e  
Rregullores Nr. 2 për Organizimin  
e Brendshëm, Punësimin dhe  
Shpërblimin e Personelit të Fondit  
të Kosovës për Eficiencë të  
Energjisë, i plotësuar dhe  
ndryshuar me Rregulloren  
BDFKEE - Nr. 01/2022**

Në bazë të paragrafëve 4.2, 4.7 dhe 4.8 të nenit 42 të Ligjit Nr. 06/L-079 për Eficiencën e Energjisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 2018/21), Bordi i Drejtorëve të Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë, në mbledhjen e mbajtur më 12.04.2023, nxjerr:

**Rregullore BDFKEE- 01/2023 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 2 për Organizimin e Brendshëm, Punësimin dhe Shpërblimin e Personelit të Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë, i plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren BDFKEE -Nr. 01/2022**

**Neni 1  
Qëllimi**

Kjo Rregullore ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 2 për Organizimin e Brendshëm, Punësimin dhe Shpërblimin e Personelit të Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë, i plotësuar dhe ndryshuar (këtu e tutje: Rregullorja bazë), me qëllim të ndryshimit skemës së përgjithshme të kompensimit në FKEE.

**Neni 2**

Shfuqizohet paragrafi 2 dhe 3 i neni 11 të Rregullores bazë.

**Neni 3**

Neni 37 i Rregullores bazë, ndryshohet si në vijim:

**Neni 37**

1. Anëtarët e Bordit Drejtues dhe personelit të FKEE-së marrin shpërblime financiare në këmbim të shërbimeve të tyre të ofruara FKEE-së sipas skemës së përgjithshme të kompensimit të paraqitur bashkëngjitur në Shtojcën Nr. 5 të kësaj Rregulloreje, ku për çdo pozitë në FKEE është përcaktuar koeficienti më i ultë dhe më i lartë për kompensim.
2. Vlera e monetare e koeficientit përcaktohet me vendim të Bordit të FKEE-së, sipas planifikimeve buxhetore për vitin përkatës buxhetor.
3. Lartësia e koeficientit për Drejtorin Menaxhues të FKEE-së përcaktohet me vendimin e Bordit të FKEE-së, ndërsa lartësia e koeficientit të personelit të FKEE-së përcaktohet nga Drejtori Menaxhues si FKEE-së.
4. Autorizohet Drejtori Menaxhues i FKEE-së për ekuivalentimin e vendeve të punës me skemën e përgjithshme të kompensimit, në pajtim me Shtojcën 4.

#### Neni 4

Shfuqizohet neni 38 i Rregullores bazë.

#### Neni 5

Shfuqizohet Shtojca 4 e Rregullores bazë, së bashku me tabelat përcjellëse, dhe zëvendësohet me Shtojcën 4, sipas kësaj rregulloreje.

#### Neni 6

Shfuqizohet Shtojca 5 e Rregullores bazë, së bashku me tabelat përcjellëse, dhe zëvendësohet me Shtojcën 5, sipas kësaj rregulloreje.

#### Neni 7

#### Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit të saj dhe krijon efekt financiar nga data 1 prill 2023.

(e nënshkruar)

  
Enis Spahiu  
Kryesuesi i Bordit



Prishtinë, 12.04.2023

Shtojca 4: Ekuivalentimi i pozitave aktuale; Katalogu i vendeve të punës, gradat dhe niveli i pagës sipas skemës së re

| Nr | Grada | Pozita (titulli)                           | Njësia                                     | Kategoria Funktionale | F/SHM/C | Përvoja totale e punës | Përvoja Relevante |
|----|-------|--------------------------------------------|--------------------------------------------|-----------------------|---------|------------------------|-------------------|
| 1  | E1    | Drejtori Menaxhues & Anëtar Bordi          | Zyra e Drejtorit                           | Nivel Ekzekutiv       | F       | 10                     | 5                 |
| 2  | E3    | Udhëheqësi i zyrës                         | Zyra e Drejtorit, Njësi implementuese      | Nivel Menaxherial     | F       | 5                      | 3                 |
| 3  | A1    | Asistenti Ekzekutiv                        | Zyra e Drejtorit                           | Nivel Administrativ   | F       | 3                      | 3                 |
| 4  | E3    | Udhëheqës Njësise                          | Zyra Qendrore                              | Nivel Menaxherial     | F       | 5                      | 3                 |
| 5  | P2    | Zyrtar për Marrëdhënie me Publikun         | Zyra për marrëdhënie me publikun           | Nivel Profesional     | F       | 5                      | 3                 |
| 6  | A2    | Zyrtar Administrativ & logjistike          | Zyra për çështje administrative            | Nivel Administrativ   | SHM     | 3                      | 2                 |
| 7  | E2    | Udhëheqës i Departamentit                  | Shërbimet e Përgjithshme                   | Nivel Menaxherial     | F       | 8                      | 4                 |
| 8  | P1    | Zyrtar i Lartë Ligjor (Senior)             | Ligjore                                    | Nivel Profesional     | F       | 5                      | 3                 |
| 9  | P2    | Zyrtar Ligjor (Junior)                     | Ligjore                                    | Nivel Profesional     | F       | 5                      | 3                 |
| 10 | P2    | Zyrtari i Burimeve Njerëzore               | Burime Njerëzore                           | Nivel Profesional     | F       | 5                      | 3                 |
| 11 | IT1   | Zyrtari i TI-së                            | Shërbime për Teknologji dhe Informim       | Ekspert/Profesional   | C       | 3                      | 3                 |
| 12 | EXP1  | Zyrtari i Prokurimit                       | Prokurimi dhe Menaxhimi Kontratave         | Ekspert               | F       | 5                      | 3                 |
| 13 | EXP1  | Zyrtari Kontraktues                        | Prokurimi dhe Menaxhimi Kontratave         | Ekspert               | F       | 5                      | 3                 |
| 14 | E2    | Udhëheqës i Departamentit                  | Sektori i Financave                        | Nivel Menaxherial     | F       | 8                      | 4                 |
| 15 | E2    | Përgjegjës                                 | Kontrolli i Brendshme, Njësi implementuese | Nivel Menaxherial     | F       | 8                      | 4                 |
| 16 | P2    | Zyrtar financiar / Auditor/Kontrollor      | Financa dhe Kontroll                       | Nivel Profesional     | F       | 5                      | 3                 |
| 17 | P2    | Zyrtar financiar/kontabilist               | Kontabilitet dhe Raportim                  | Nivel Profesional     | F       | 5                      | 3                 |
| 18 | P1    | Zyrtar i lartë për financa/kontabilitet    | Financa dhe Kontroll                       | Nivel Profesional     | F       | 5                      | 3                 |
| 19 | E2    | Udhëheqës i Departamentit                  | Sektori për Operacione                     | Nivel Menaxherial     | F       | 8                      | 4                 |
| 20 | IN1   | Inxhinier i lartë elektrik                 | Inxhinier Elektrike                        | Nivel Profesional     | F       | 8                      | 3                 |
| 21 | IN2   | Inxhinier elektrik                         | Inxhinier Mekanik                          | Nivel Profesional     | F       | 8                      | 3                 |
| 22 | IN2   | Inxhinier mjedisor                         | Inxhinier Mekanik                          | Nivel Profesional     | F       | 8                      | 3                 |
| 23 | IN2   | Inxhinier civilë dhe/ose arkitektë         | Inxhinier Mekanik                          | Nivel Profesional     | F       | 8                      | 3                 |
| 24 | IN1   | Inxhinier i lartë civilë dhe/ose arkitektë | Inxhinieri Civil                           | Nivel Profesional     | F       | 8                      | 3                 |

Shtojca 5: Skema e Përgjithshme e Kompensimit

|      |                                     |                                                         |                           |       |       |
|------|-------------------------------------|---------------------------------------------------------|---------------------------|-------|-------|
| A1   | Asistenti Ekzekutiv                 | Zyra e Drejtorit                                        | Nivel Administrativ       | 8.00  | 10.00 |
| A2   | Asistent Administrativ & logjistike | Zyra për çështje administrative                         | Nivel Profesional         | 7.00  | 8.50  |
| E1   | Drejtori Menaxhues & Anëtar Bordi   | Zyra e Drejtorit                                        | Nivel Ekzekutiv           | 27.50 | 35.00 |
| E2   | Udhëheqës/Përgjegjës                | Departament, Njësi Implementuese, Kontroll e Brendshme  | Nivel Menaxherial         | 18.00 | 21.00 |
| E3   | Udhëheqës i Mesëm                   | Zyra e Drejtorit, Sektor/Njësi, Njësi Implementuese     | Nivel Menaxherial         | 13.00 | 14.70 |
| EXP1 | Zyrtari i Prokurimit/Menaxhimit     | Prokurimi dhe Menaxhimi Kontratave/Projektit            | Ekspert                   | 15.00 | 17.50 |
| IN1  | Inxhinier i larte                   | Inxhinieri Elektrike, Mekanike, Civile/arkitekt, Mjedis | Nivel Profesional         | 16.00 | 17.50 |
| IN2  | Inxhinier                           | Inxhinieri Elektrike, Mekanike, Civile/arkitekt, Mjedis | Nivel Profesional         | 15.00 | 16.50 |
| IT1  | Zyrtari i IT-së                     | Shërbime për Teknologji dhe Informim                    | Nivel Profesional/Ekspert | 15.00 | 17.00 |
| P1   | Zyrtar i Lartë (Senior)             | Ligjor, financiar, BNJ, etj.                            | Nivel Profesional         | 14.00 | 16.00 |
| P2   | Zyrtar (Junior)                     | Ligjor, financiar, BNJ, etj.                            | Nivel Profesional         | 12.00 | 14.00 |
| BoD1 | Kryesues i Bordit të Drejtorëve     | N/A                                                     | N/A                       | 6.50  |       |
| BoD2 | Anëtari i Bordit të Drejtorëve      | N/A                                                     | N/A                       | 6.00  |       |